



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 457/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, përkitazi me ankesën e Koalicionit për Kosovën e Re (AKR) e cila i drejtohet Korporates Elektroenergjitike të Kosovës (KEK) në lidhje me parregullsi gjatë procesit zgjedhor, në seancën e mbajtur më 13.12.2010, mori:

VENDIM

HIDHET poshtë si e palejuar ankesa e Koalicionit për Kosovën e Re

ARSYETIMI

Më datë 12.12.2010 PZAP-i ka pranuar ankesë nga Koalicioni për Kosovën e Re dega Prishtinë, e cila i drejtohet KEK, pasi me datë 12.12.2010 ka pasur mungesë të energjisë elektrike në disa fshatra (të papërcaktuara), fakt ky që sipas parashtrësive të ankesës përben tendencë të vazhdueshme dhe presion nga komisionarët e partive të mëdha për të hyrë në kompromis për tjetërsimin e vullnetit të qytetarëve.

Në mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë materiale, me propozim që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Neni 59 paragrafi 2 i LZP-së, specifikon si më poshtë:

59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji;

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 6.4 (Vendimet për Ankesat) parasheh si vijon:

6.4 *Panelet mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo at të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e palejuar

Ne baze te dispozitave te lartpërmendura, PZAP-i vlerëson se ankesa e Koalicionit per Kosoven e Re paraqitur kundrejt KEK-ut ne lidhje me mungesën e energjisë elektike ne disa fshatra përgjatë ditës se zgjedhjeve 12.12.2010, nuk është nen juridiksionin e tij. Prandaj për këtë arsye dhe ne pajtim te dispozitave ligjore te cekura me larte si dhe ne pajtim te nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa

A nr. 457/2010 më datën 13.12.2010.

Kryesuesi i Panelit

Muharrem Shala

